



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.34/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afiete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtaren e lartë ligjore, Florije Krasniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në shenja publike të trafikut, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,700.00 (njëmijë treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme, më datën 01.06.2017, në rrugën Prishtinë Pejë, përkatësisht tek rrethrotullimi në hyrje të Prishtinës si dhe në semaforët tek udhëkryqi tek Katedralja, monitoruesit e tyre kanë hasur në posterat e kandidatëve për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në rrethrotullim dhe shenjat e trafikut-semafor.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni PDK-AAK-NISMA ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në shenjat publike të trafikut.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur tre fotografi të printuara si dhe një CD me dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Koalicioni PDK-AAK-NISMA, të datës 03.06.2017, ka theksuar se në momentin që kanë pranuar kërkesën për përgjigje kanë ndërhyrë shpejtë duke i larguar posterat nga vendet e caktuara.

Dhe si provë për të dëshmuar përmirësimet e tyre kanë bashkangjitur foto nga vendi i caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicioni PDK-AAK-NISMA janë të vendosura në shenjat publike të tafikut, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Si rrethanë mori se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet janë të vendosur në rrethrotullim dhe në shenjat publike të tafikut-semafor. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që Koalicioni PDK-AAK-NISMA ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe ka bërë përmisimin e shkeljes ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se kanë ndërmarrë veprime për të tërhequr posterat në vendet e palejuara.

PZAP-i, pasi vlerësoi pretendimet ankimore sipas kriterëve të përcaktuara më lart, konstatoi se nga ana e Koalicioni PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b) të LZP-së, pasi që nga provat e ofruara shihet qartë se posterat e kandidatëve të subjektit të tij janë vendosur në rrethrotullim dhe në shenjat publike të tafikut-

semafor, si dhe duke marrë parasysh se Koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka bërë veprime për ta përmirësuar shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike respektivisht largimin e posterave ashtu siç është urdhëruar nga PZAP-i, me parashtrësën e datës 03.06.2017, që ta përmirëson shkeljen e theksuar më lart dhe në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar.

Andaj, PZAP-i në kuptim të nenit 3 par.2 të Rregullës Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it dhe kuptim të nenit 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësra**

Anr.34/2017 më datën 05.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

**Zyhdi Haziri**



**Kwshilla Juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.